



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____

Lënda: Depozitohet propozimi për ndërmarrjen e nismës ligjore për disa ndryshime ne ligjin nr 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA

KRYETARE E KUVENDIT

E nderuar Kryetare ,

Me qëllim lehtësimin e procedurave administrative dhe përfitimin e shërbimeve më të mira dhe ekonomike, ndaj qytetarit të krahasueshme me vendet më të zhvilluara sa i përket kërkesave për drejtimin e mjeteve rrugore, afateve dhe konfirmimeve të vlefshmerisë se lejes së drejtimit si dhe mbi kufizimet për drejtuesit e motomjeteve , të parashikuara në dispozitat respektive të ligjit nr 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”i ndryshuar, propozojmë amendamentet si më poshtë:

Neni 114: “Kërkesat për drejtimin e mjeteve dhe kafshëve” pika 2 është:

2. Cilido, që drejton mjete me motor, nuk duhet të ketë kaluar moshën:

- "a) shtatëdhjetë vjeç, për të drejtuar mjete me motor për transport malli;
- b) gjashtëdhjetë e pesë vjeç, për të drejtuar autobusë, kamionë, kamionë me rimorkio, gjysmërimorkiatorë dhe artikularë të tjerë, të caktuar për transport personash. Ky kufi mund të rritet çdo vit deri në shtatëdhjetë vjeç, kur drejtuesi paraqet një dëshmi të veçantë për kërkesat fizike dhe psikike, pas një vizite të specializuar mjekësore të përvitshme, sipas mënyrave të përcaktuara në aktet në zbatim

Propozim: Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

2. Cilido, që drejton mjete me motor, nuk duhet të ketë kaluar moshën:

- a) shtatëdhjetë vjeç, për të drejtuar autobusë, kamionë, kamionë me rimorkio, gjysmërimorkiatorë, artikularë të tjerë, të caktuar për transport personash dhe mjete me motor për transport malli;
- b) Shfuqizohet.

Neni 117/1 “Kufizime për drejtuesit e motomjeteve” pika 1 dhe 2 është:

- 1. Zotëruesit e lejedrejtimeve vendase të grupit "A" për tre vitet e para pas marrjes së lejedrejtimit nuk u lejohet drejtimi i motomjeteve me fuqi prej 25 kË specifike referuar ngarkesës, ose 0,16 kË/kg.
- 2. Në Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor përcaktohen modalitetet e shënimit në lejen e qarkullimit të kufizimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Në mënyrë të njëjtë vendosen normat për mjetet në qarkullim nga data e hyrjes në fuqi e këtij Kodi.

Propozim: Pas pikës 1 të shtohet, pika 1/1 dhe 1/2 me përmbajtjet si më poshtë:

- 1/1. Për tre vitet pas datës së marrjes së lejedrejtimit të kategorive A2, A, B1 dhe B, nuk lejohet tejkalimi i shpejtësisë prej 80 km/orë për autostrada dhe 70 km/orë për rrugët interurbane kryesore.
- 1/2. Mbajtësit e lejeve të drejtimit të kategorisë B, në tri vitet e para të lëshimit, nuk u lejohet të drejojnë mjete motorike me fuqi specifike, referuar masës bosh të mjetit, më e lartë se 55 kË/t. Në rastin e automjeteve të kategorisë M1, zbatohet një kufi shtesë i fuqisë maksimale prej 70 KË për qëllimet e përmendura në periudhën e mëparshme. Për makinat hibride elektrike ose plug-in, kufiri specifik i fuqisë është 65 kË/t duke përfshirë peshën e baterisë.

Të ndryshohet pika 2 me përmbajtjen si më poshtë:

- 3. Në Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor përcaktohen modalitetet e shënimit në lejen e qarkullimit të kufizimeve të parashikuara në pikën 1, 1/1, 1/2 të këtij neni. Në mënyrë të njëjtë vendosen normat për mjetet në qarkullim nga data e hyrjes në fuqi e këtij Kodi.

Neni 124 “Afati dhe konfirmimi i vlefshmërisë së lejedrejtimit të mjetit”, pika 1, pika 2, pika 3, pika 4 dhe pika 6 është:

- 1. Lejedrejtimet e mjeteve të kategorive AM, A1, A2, A, B1, B dhe BE, sipas grup-moshave, janë të vlefshme për:
 - 10 vjet, nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri në moshën 50 vjeç;
 - 5 vjet, për ata që e kanë kaluar moshën 50-vjeçare;
 - 3 vjet, për ata që i kanë kaluar të 70-at.

2. Lejedrejtimit e mjeteve të kategorive C1, C1E, C dhe CE, sipas grup-moshave, janë të vlefshme për:

- 5 vjet, nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri në moshën 65 vjeç;
- 2 vjet, për persona mbi 65 vjeç.

Sipas parashikimit të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 114, për personat mbi 65 vjeç, lejedrejtimi e kategorive C dhe CE lëshohet për drejtimin e mjeteve, masa e përgjithshme e të cilave, me ngarkesë të plotë, nuk është më shumë se 20 tonë.

3. Lejedrejtimit e mjeteve të kategorive D1, D1E, D dhe DE, sipas grup-moshave, janë të vlefshme për:

- 5 vjet, nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri në moshën 65 vjeç;
- 3 vjet, për persona nga 65 vjeç e lart.

Sipas parashikimit të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 114, për personat mbi 65 vjeç, lejedrejtimi e kategorive D1 ose D, apo D1E ose DE lëshohet vetëm për drejtimin e mjeteve, për të cilat kërkohet pajisja me lejedrejtimi përkatësisht të kategorisë B ose BE.

4. Lejedrejtimit e posaçme të mjeteve, lëshuar për personat me aftësi të kufizuara, të kategorive AM, A1, A2, A, B1, B dhe BE, janë të vlefshme për:

- 5 vjet, nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri moshën 60 vjeç;
- 3 vjet për persona mbi 60 vjeç.

5. Lejedrejtimit e posaçme të mjeteve, lëshuar për personat me aftësi të kufizuara, të kategorive C1, C1E, C dhe CE, janë të vlefshme për:

- 5 vjet, nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri moshën 50 vjeç;
- 3 vjet, kur mbajtësi i saj është mbi 50 vjeç.

Këto leje nuk rinovohen pas moshës 65 vjeç.

6. Mbajtësit e lejedrejtimit të automjetit, sipas pikave 2, 3, 4 dhe 5, kur mbushin 80 vjeç rifreskojnë vlefshmërinë e lejedrejtimit çdo vit pas verifikimit të ekzistencës së të dhënave fizike dhe mendore nga komisionet mjekësore përkatëse, duke u bazuar në pikën 5 të nenit 117.

Propozim: Pika 1, pika 2, pika 3, pika 4 dhe pika 6 të ndryshohen si më poshtë:

1. Lejedrejtimit e mjeteve të kategorive AM, A1, A2, A, B1, B dhe BE sipas grup-moshave, janë të vlefshme për:

- 15 vjet, nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri në moshën 70 vjeç;

- për personat mbi 70 vjeç konfirmimi i vlefshmërisë së lejes së drejtimit bëhet duke dorëzuar certifikatë mjekësore të lëshuar nga një prej organeve mjekësore të përmendura në pikën 2, të nenit 117, jo më shumë se gjashtë muaj përpara, nga e cila të rezultojë që zotëruesi i kësaj certifikate plotëson të gjitha kërkesat fizike e psikike të kërkuara.

2. Lejedrejtimit e mjeteve të kategorive C1, C, D1, D, C1E, CE, D1E, D dhe DE sipas grup-moshave, janë të vlefshme për:

- 5 vjet, nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri në moshën 70 vjeç;

Sipas parashikimit të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 114, për personat mbi 65 vjeç, lejedrejtimi e kategorive C dhe CE lëshohet për drejtimin e mjeteve, masa e përgjithshme e të cilave, me ngarkesë të plotë, nuk është më shumë se 20 tonë.

Sipas parashikimit të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 114, për personat mbi 65 vjeç, lejedrejtimi e kategorive D1 ose D, apo D1E ose DE lëshohet vetëm për drejtimin e mjeteve, për të cilat kërkohet pajisja me lejedrejtimi përkatësisht të kategorisë B ose BE.

3. Shfuqizohet.

4. Lejedrejtimit e posaçme të mjeteve, lëshuar për personat me aftësi të kufizuara, të kategorive AM, A1, A2, A, B1, B dhe BE, janë të vlefshme për:

- 5 vjet, nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri moshën 65 vjeç;

5. Lejedrejtimit e posaçme të mjeteve, lëshuar për personat me aftësi të kufizuara, të kategorive C1, C1E, C dhe CE, janë të vlefshme për:

- 5 vjet, nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri moshën 65 vjeç;

Këto leje nuk rinovohen pas moshës 65 vjeç.

6. Shfuqizohet.

Duke ju falenderuar për vëmendjen,

KRYETARI I GRUPIT PARLAMENTAR TË PSSH-së

Taulant BALLA

